



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1087/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Agrikulturë dhe Mjedis MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;*
- II. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Shkenca e Ushqimit dhe Bioteknologji BSc 180 ECTS, me specializimet: 1. Teknologjia e Ushqimit, dhe 2. Nutricion, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I dhe II zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimet e bartësve bëhen me vendim nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 3

ARSYETIM

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me bartësit e programeve si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Agrikulturë dhe Mjedis MSc 120 ECTS;</i>	Ismet Babaj Sami Makolli
2.	<i>Shkenca e Ushqimit dhe Bioteknologji BSc 180 ECTS, me specializimet: 1. Teknologjia e Ushqimit, dhe 2. Nutricion.</i>	Mërgim Mestani Vesë Pakashtica Arianeta Nura Hyzer Rizani Mufail Salihaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Agrikulturë dhe Mjedis MSc 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Joachim Muller, Damir Magdic dhe Katerina Klimoska është organizuar më 27.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Shkenca e Ushqimit dhe Bioteknologji BSc 180 ECTS, me specializimet: 1. Teknologjia e Ushqimit, dhe 2. Nutricion***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Damir Magdic, Joachim Muller dhe Katerina Klimoska është organizuar më 03.04.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të të mbajtur më datë 27.03.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegji UBT kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shkollor të Cilësisë

